



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 23.04.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2018**

I. Hyrje

Komisioni për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim Raportin vjetor të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, për vitin 2018 në mbledhjet e tij të datave 16, 17 dhe 23 prill 2019.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 16 prill për të bërë prezantim e raportit vjetor, si dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve të deputeteve ishin Komisioneri znj. Pranvera Strakosha dhe përfaqësues të tjerë të këtij insitucioni

Komisioni caktoi relator për këtë çështje z. Alket Hyseni.

II. Baza ligjore

Bazuar në nenin 11, pika 5, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin vjetor të veprimtarisë së tij për vitin 2018.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1, e Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën e paraqet në seancë plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018, si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2019.

IV. Diskutimi në Komision

Në paraqitjen e veprimtarisë së Komisionerit, znj. Pranvera Strakosha në fjalën e saj paraqiti drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm si dhe prioritetet kryesore të tij për vitin 2019.

Relatori, i caktuar nga Komisioni për këtë çështje z. Alket Hyseni, paraqiti një informacion me vlerësimet e tij për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni si dhe disa rekomandime për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim.

Anëtarët e Komisionit kërkuar nga Komisioneri informacione shtesë për veprimtarinë e tij dhe vlerësuan punën e kryer nga insitucioni gjatë vitit 2018, e cila ka rezultuar edhe në përmbushje të kërkesave të rezolutës së mëparshme të Kuvendit, si dhe vlerësimet e organizmave ndërkombëtarë.

Në mbledhjet e datave 17 dhe 23 prill, Komisioni u mbledh për të shqyrtuar draftin e Projektrezolutës së përgatitur nga Relatori, i cili pasqyron të dhënat e raportuara për aktivitetin e Komisionerit, si dhe çështjet e diskutuara në seancën dëgjimore të datës 16 prill.

V. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi Projektrezolutën me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet për miratim seancës plenare sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

Alket HYSENI

KRYETAR

Ulsi MANJA